

VENDIM
Nr. 31, datë 1.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PËRDORIMIN E
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT NË
SUBJEKTET E LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, të nenit 43, shkronja “c”, dhe nenit 70, pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 3.5.2006, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) përmbajtja e nenit 1 ndryshon si më poshtë:

“Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të ligjit 52/2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”. ”;

b) në nenin 3, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, përmbajtja e shkronjave “a” dhe “b” ndryshon si më poshtë:

“a) subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë;

b) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”. ”;

ii. pika 2 shfuqizohet;

c) neni 14 shfuqizohet;

d) përmbajtja e nenit 16 ndryshon si më poshtë:

“Neni 16
Masat korrigjuese dhe penalitetet

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore ose penalitetet e parashikuara në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”. ”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2028.

KRYETAR
Gent Sejko

